



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr 030-27086 dt. 13 06 2022

Në bazë të nenit 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 72 paragrafi 1 pika (h) të Statutit të Komunës së Glllogocit, në bazë të nenit 5 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 11, dhe nenit 16 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH-nr.08/2017 mbi Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, vendimin për pëlqim mjedisor për raportin e vlerësimit strategjik mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit Nr.3902-2/20 datë 22.09.2020, vendimin për dhënien e pëlqimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit 2022-2030 Nr.2586-2/22 datë 10.06.2022 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM
Për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën
2022-2030

Neni 1

Miratohet vendimi për Hartën Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën tetë (8) vjeçare 2022-2030. Harta Zonale e Komunës së Glllogocit është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës së Glllogocit.

Neni 2

Me miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit shfuqizohen Planet Rregulluese Urbane të Komunës së Glllogocit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komunës.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Glllogocit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



ARSYETIM

Bazuar në obligimet ligjore që përcaktohen në Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Komuna e Glllogocit ka filluar me procesin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit.

Procesi i hartimit të HZK-së ka filluar me Vendimin 12-Nr.353-6550, për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit të marrë nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit me datë 31.01.2018, në të cilën bartës i procesit të hartimit të HZK-së është përcaktuar Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Për të udhëhequr procesin e planifikimit në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, komuna ka themeluar dy mekanizma:

- Ekipin Komunal për Planifikim (EKP) - të përbërë nga të gjitha drejtoritë e komunës së Glllogocit (Drenasit). Ekipi Komunal i Planifikimit ka shërbyer si platformë për të mbledhë informata nga të gjitha drejtoritë dhe kompanitë publike në komunë, si dhe për të dhënë kontribut në përmbajtjen e HZK-së në të gjitha fazat e hartimit të tij. Për më shumë EKP ka shërbyer për të harmonizuar kërkesat dhe projektet të të gjithë sektorëve në komunë.
- Ekipin Këshillues të Komunitetit (EKK) – të përbërë nga të gjitha komunitetet në komunën e Glllogocit (Drenasit). Anëtarët e EKK-së janë përfaqësues të shoqërisë civile, të rinjëve, grave, të moshuarve, personave më aftësi të veçanta, bizneseve, komuniteteve fetare dhe kryetarë të bashkësive lokale. EKK ka shërbyer si urë lidhëse në mes të komunës dhe qytetarëve të komunës. Detyrë primare e EKK-së ka qenë komunikimi me qytetarë rreth përmbajtjes së HZK-së në faza të ndryshme të hartimit.

Procesi i hartimit të HZK-së ka kaluar në katër faza kryesore siç janë: Kushtet e përgjithshme zhvillimore, lista e zonave, zonat e përcaktuara dhe kushtet zhvillimore të tyre, kushtet zhvillimore për shfrytëzimet e veçanta, zonat mbishtresore dhe kushtet zhvillimore të tyre, infrastruktura rrugore, infrastruktura publike dhe sociale, infrastruktura teknike, trajtimi i vendbanimeve joformale, plani i veprimit për zbatim të Hartës Zonale të Komunës.

Harta Zonale e Komunës, është një dokument i planifikimit hapësinor, në të cilën përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General Secretary

Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar nën 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7,01 Mars 2019), Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive endryshuar dhe plotësuar me Rregullore (QRK) Nr. 04/2021, si dhe nën 9 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nxjerrë:

V E N D I M

për dhënien e pëlqimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit 2022-2030


Departamenti për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas verifikimit të përputhshmërisë së projekt - Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit 2022-2030, me Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjinë e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+ dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, jep pëlqim për miratim të Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit 2022-2030.

A r s y e t i m

Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit të Komunës së Gllgocit, me shkresë zyrtare të datës 06.05.2022 me Nr. Prot.: 2586/22, kërkon nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit pëlqim për miratim të Projekt - Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit 2022-2030, sipas procedurës ligjore pas shqyrtimit publik të hapur më datën 10.08.2021 deri më 10.09.2021.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit dhe vlerësimit të projekt - Hartës Zonale të Komunës së Gllgocit 2022-2030 dhe dokumentacionit përcjellës si Raporti i Vlerësimit Strategjikë Mjedisor dhe Raporti nga Shqyrtimi Publik, konstaton se ky dokument:

1. I plotëson kushtet ligjore të parapara me Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor mbi procedurat e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor;
2. Është në pajtim me nenin 16 dhe 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
3. Është në përputhshmëri me Planin Hapësinor të Kosovës - Strategjinë e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+;



4. Është në pajtim me Udhëzimin Administrativ MMPH-NR.24/2015 mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.
5. Është në pajtim me Udhëzimin Administrativ MMPH - Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Komuna e Gillogocit brenda shtatë (7) ditëve pas miratimit të dokumentit të planifikimit hapësinor nga Kuvendi i Komunës duhet të dorëzojë në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Hartën Zonale të Komunës së Gillogocit 2022-2030, me qëllim të sigurimit të saktësisë dhe kompletimit të dhënave të përfshira në bazën e të dhënave të planifikimit hapësinor, sipas neni 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11 i Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.


“Harta Zonale e Komunës së Gillogocit 2022-2030” duhet të dorëzohet në Departamentin për Planifikim Hapësinor, Ndërtim dhe Banim në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës para se të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit për miratim të Hartës Zonale të Komunës, në kuptim të nenit 81 të Ligji Nr. 03/L-040 mbi Vetëqeverisjen Lokale.

Komuna e Gillogocit gjatë hartimit të Hartës Zonale të Komunës është bazuar në Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028 dhe dokumentet e tjera të planifikimit hapësinor të komunës në fuqi.

Bazuar në kërkesat e reformës ligjore, objektivat e planeve zhvillimore dhe strategjike të sektorëve të qeverisë dhe të komunës, miratimit të ligjeve që ndikojnë në fushën e zhvillimeve në legjislacion dhe zbatimit të projekteve nga niveli qendror duke përfshirë gjendjen ekzistuese të krijuar në teren në tërësi, në raste të caktuara këto objektiva dhe caqe nuk kanë qenë të mjaftueshme për përcaktimin e saktë të sipërfaqeve dhe masave për të gjithë sektorët.

“Harta Zonale e Komunës së Gillogocit 2022-2030” duhet të përkthehet në gjuhën serbe ashtu si parashihet në nenin 5 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Servet Spahiu


Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Kabinet of the Minister

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenit 2 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230, nxjerr këtë:

V E N D I M

"Komuna e Glogocit" Glogocit, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, pajiset me Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028

A r s y e t i m

Komunës së Glogocit, Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028, proces verbalin i Debatit Publik për draft Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028, listen e pjesëmarrësve në Debat Publik, Proces verbalin e debatit publik të dorëzuar nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Glogocit.

Faqe 2 nga 3

Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit merr vendim për lëshuarjen e **Pëlqimit Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Gllogocit 2020-2028

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Nr.: 20/3902/1 -444/ /20 datë: 14.09.2020

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VSM
3. Inspektoratit të MIA-së
4. Zyrës të Sekretarit të Përgjithshëm
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivi i MEA
7. Kuvendit të Komunës së Gllogocit

Blerim Kuçi

Ministër i Ekonomisë dhe Ambientit



Faqe 3 nga 3